

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Shërbim

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Rinovimi dhe Certifikimi ISO 27001”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

79130000-4 - Shërbime të dokumentimit dhe certifikimit ligjor

VLERA E FONDIT LIMIT:

2,800,000 (dy milion e tetëqind mijë) Lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **“Operatori i Sistemit te Transmetimit” (OST) sh.a.** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme): me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatori ekonomik ofertues duhet të ketë xhiro minimale vjetore të realizuar, për periudhën e 3 (tre) viteve të fundit financiare, te paktën 1,100,000 (një milion e njëqind mijë) Lekë.

Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Si prove per plotesimin e ketij kriteri kualifikues, operatori ekonomik ofertues duhet te disponoje vertetim nga Administrata Tatimore ku te tregohet xhiroja vjetore per vitet e siperpermendura dhe kopje të certifikuara të bilanceve ku të paktën në dy bilance të fundit, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë cilësinë dhe llojin e shërbimit objekt procedure prokurimi, kërkohej që OE ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për të realizuar ato në kohë dhe në përputhje me Termat e Referencës të kërkuara. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim, është argumentuar se vlera e xhiros së kërkuar të jete në masën 1,100,000 (një milion e njëqind mijë) Leke.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, kontrata të ngjashme në një vlerë të pakten prej 500,000 (pesëqind mijë) Lekë.

Lidhur me këtë pikë:

Kur OE ka realizuar kontrata me një ent publik, kërkohej vërtetimi të lëshuara nga ky i fundit, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

***Shenim:** Operatori Ekonomik ofertues duhet te paraqese shembuj te certifikimit sipas standardit ISO 27001.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më shumë se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës të përcaktuar në nenin 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë cilësinë dhe llojin e shërbimit objekt procedure prokurimi, është menduar se vlera e kërkuar që OE ofertues të ketë bërë me kontrata të ngjashme, të jetë afër limitit maksimal dhe në këtë mënyrë, AK ka sigurinë dhe besueshmërinë që OE ofertues mund të realizojë kontratën objekt prokurimi pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikonin në ecurinë e punës së AK.

2.3.2 *Operatori Ekonomik ofertues duhet të jetë i akredituar nga enti i akreditimit shtetëror shqiptar, ose organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, kjo e dëshmuar me certifikate leshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA), ose nga ente akredituese ndërkombëtare të njohura në Republikën e Shqipërisë, si pjesë e IAF dhe/ose EA.*

Argumentimi: Operatori ekonomik duhet të jetë i akredituar dhe i kontrolluar nga ente certifikuese për shërbimet e konsulentëve, implementimi apo certifikimit të standardeve ndërkombëtare, jep siguri për ne si Autoritet. Përveç se përmbush edhe kriteret e kërkuara të udhëzimeve të ENTSO-E. Ky kriter është bazuar në nenin 44, pika 1 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.3.3 *Operatori Ekonomik duhet të ketë të paktën 1(një) konsulent për hartimin e dokumentacionit, implementimin dhe asistencën për standardin ISO/IEC 27001: . Kjo e vertetuar nga dokumentacione të ndryshme (trajnime, ekspierenca pune, CV, vertetime nga kompani të ndryshme, libereze pune, listepagesen e fundit e-sig). Gjithashtu OE të ketë pjesë të stafit të tij, ose të kontraktuar me qëllim realizimin e kësaj procedure prokurimi, 1(një) person me kualifikime apo trajnime të ndryshme mbi ISO 27001 ose Sigurinë e të Dhenave apo Informacionit.*

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 9.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, duhet të dorëzojë pranë AK, përpara lidhjes së kontratës, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Argumentimi: Kërkesa për stafin e kualifikuar të kërkuar, bëhet me qëllim përmbushjen e kontratës, sipas përshkrimit të bërë në Termat e Referencës. Konsulenti i kërkuar do të përgatisë dokumentacionin e nevojshëm, ndërsa punonjësi i kualifikuar do të bëjë trajnimet e nevojshme, në përmbushje të kërkesës së Termave të Referencës.

Ky kriter është bazuar në nenin 41, pikë 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.3.4 Në funksion të plotësimit të Shtojcës 9 “Formulari përmbledhës i vetedeklarimit” Operatori Ekonomik ofertues duhet të japë të dhëna të qarta si Emër, Mbiemër, Atesë, Amësi, Datëlindje, Vendlindje, Numer Personal, si dhe kopje të skanuara të dokumentit të identifikimit (shqiptar ose të huaj), për Administratorin/Administratoret e shoqërisë, Ortakun/Ortakët e shoqërisë, përfaqësues të ndryshëm të posaçëm të shoqërisë, drejtues të ndryshëm të shoqërisë.

Argumentimi: Ky kriter vendoset referuar njoftimit të përbashkët Nr. 1155 prot, datë 01.02.2019, të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe të Ministrisë së Drejtësisë Nr. 1001/1 prot, datë 01.02.2019, sipas parashikimeve të nenit 76/1, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, Autoriteti Kontraktor OST sh.a. ka detyrimin e verifikimit të personave të cilët janë në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik.

Për këtë arsye, verifikimi i këtyre personave kërkon të dhëna të sakta si emër, mbiemër, atesë, amësi, vendlindje, datëlindje e numrin personal të personit.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike – Termat e Referencës, janë hartuar duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, për shërbimin objekt procedure prokurimi, bazuar në karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare, sipas parashikimeve të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.